REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Nr. 01-112102-30379
Datë 17.12.2020

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 paragrafi (f) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe nenit 58 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, merr këtë:

V E N D I M

1. Znj.Valbona Naka, e sistemuar sipas akt emërimit me numër 01 Nr. 112-143/5 të datës 12.03.2012, Udhëheqëse e Kadastrit për Çështje Pronësorë Juridike në kuadër të Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, e pezulluar nga detyrat e punës me vendim numër 01-116-21952/2016, të datës 21.04.2016, nga data 21.12.2020, rikthehet në punët dhe detyrat e punës si Udhëheqëse e Sektorit për Çështje Pronësorë Juridike, në kuadër Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë;

2. Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Udhëheqëse e Sektorit për Çështje Pronësorë Juridike, rregullohet konform Rregullores (Qrk) Nr.26/2020 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil;

3. Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

A r s y e t i m

Me Vendimin nr. 01-116-21952/2016, të datës 21.04.2016, znj. Valbona Naka, Udhëheqëse e Kadastrit për Çështje Pronësorë Juridike është pezulluar me pagese 50% të rrogës se saj, menjëherë nga detyra deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Gjykata.

Me Aktgjykim të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.309/14, të datës 21.03.2019, i plotfuqishëm me datën 11.02.2020 znj. Valbona Naka është liruar nga akuza, nga znj. Valbona Naka është pranuar kërkese me numër 01-111/01-28306, të datës 27.11.2020, për rikthimin në vende të punës.

Andaj, bazuar në dispozitat e Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe pas pranimit të aktgjykimit dhe certifikatën për evidencat e zhvillimit të procedurës penale, me numër PN. NR/5983/20 të datës 26.11.2020 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë, u vendos si në dispozitivin e këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 30 ditësh, prej ditës së pranimit e të njëjtit. Ankesa i adresohet Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Vendimi i'u dërgohet: znj. Valbona Naka, Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Arkivit.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës